



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01Nr. 060/01-1703/25
Kaçanik, 27.01.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I (parë) e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VIII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 27.01.2025, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00. Nga përbërja e përgjithshme e KPF prej 7 anëtarëve, fillimisht pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa ishin 6: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Edona Luzha. Në ndërkohë arriti edhe aëtarja Ardita Rrahmani, kështuqë pjesëmarrës të kësaj mbledhje nga pika 2 ishin të gjithë anëtarët-7. Nga Ekzekutivi i Komunës, pjesëmarrës : Nënkryetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Qamil Stagova-DUKMM, Suhad Dullovi-DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku. Nga zyrtarët, në kuadër të detyrave të punës ishin: Mavije Murseli, Makfire Malsiu. Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj: Faruk Dërmaku dhe Flora Llalloshi. Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit. Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK. Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësi, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e I (parë) të rregullt të KPF-së për vitin 2025, data 27 janar, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Plani i punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025;
3. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSB, për vitin 2024;
4. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 4 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së XI (njëmbëdhjetë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 20.12.2024/ Lënda: 01Nr. 60/01-31239/24.

2. Plani i punës i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky është një dokument që ekzekutivi në fillim të vitit e dërgon në KK për shqyrtim. Ky plan pune është bukur voluminoz, në vija të trasha gati se është i njëjtë me planet e viteve tjera, sepse natyra e punës është e njëjtë. Nënkryetari i komunës është prezentë në mbledhje. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Plani i punës së ekzekutivit është gati se i ngjashëm me ato të viteve paraprahe. Në plan janë disa gabime teknike, si diku është shënuar viti 2024. Si plan pune mendoj se është i mirë, por plani duhet me u harmonizua me buxhetin, se a ka mjete me u realizuar, për me qenë plani me konkret, sepse në bazë të buxhetit bëhet edhe plani. Sa e kam vërejtur unë, plani nuk është në përputhshmëri në buxhetin, njëjtë si në vitin e kaluar, se ju e dini se në gjatë vitit 2024 kemi bërë transaksione të mjeteve, për shkak të mos realizimit të planit.

Kryesuesi i Kuvendit: Secili plan e ka dinamiken e vet dhe koston e vet, askush nuk mundet me realizuar planin 100%. Aktivitetet si në plan, janë të planifikuara me u realizuar në këtë vit, çështja e realizimit të tyre, varet prej rrethanave që krijohen.

znj. Ardita Rrahmani: Plani kuptohet se nuk është asnjëherë i përmbushur, megjithatë ju mundoheni me i realizuar ato projekte duke iu jepni prioritet. Duke pasur parasysh se viti 2025 është vit dinamik dhe elektoral, besoj se ky plan do të gjejë zbatueshmëri me të mirë në vitin e ardhshëm.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky plan pune t'i kalohet KK në procedurë të shqyrtimit? Njëzëri u pajtuan të gjithë, atëherë konstatohet se KPF, e diskutoj Planin e Punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2025. **Ky Plan pune i kalohet Kuvendit të Komunës në procedurë shqyrtimi.**

3. Raport i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi -KKSBB, për vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: KKSBB çdo vit harton një raport pune, i cili realisht shqyrtohet në KK. Në raport janë paraqitur aktivitetet që ka zhvilluar KKSBB gjatë vitit 2024. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Të raporti i punës së KKSBB, ajo që kisha dashur me theksuar si vërejtje, se në çdo të dytën mbledhje që mbahet, pikë e rendit të punës është tema; Diskutim për qentë endacak. Unë nuk e di pse është saherë kjo temë në këtë këshill, janë procesverbalet që mundeni me i pa, ndërkaq nuk ka rezultat se çka po diskutohet, apo vetëm me konsumuar si pikë të debatit. Jeni të bindur se çdo e dyta mbledhje e KKSBB temë e ka trajtimin e qenëve endacak. Me u diskutuar kjo temë në çdo të dytën mbledhje, ndërkaq mos me pasur rezultat, mendoj se komuna jonë ka tema të shumëta që mundet me i trajtuar në KKSBB. Kjo të jetë një vërejtje prej KPF, megjithse raporti shqyrtohet edhe në KK. Kisha bërë thirrje me u bërë transmetimi live edhe i mbledhjeve të KPF, pse mos me ua mundësuar qytetarëve me pasur qasje, pavarësisht sa ka të interesuar.

Nënkryetari i Komunës: Temë e rregullt në KKSBB është pika, Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo temë është që nuk po ka zgjidhje ende në nivel vendi.

z. Rustem Zenuni: Qytetarët munden me pasur angazhime tjera gjatë mbajtjes së mbledhjes, por kur e kanë kohën e lirë, munden me pa transmetimin e mbledhjes. Shprehi shqetësimin për pirje të duhanit në hapësira të mbyllura. Kjo na bënë dëm, ndërkaq nuk po merren masa në këtë

drejtim. Shqetësim tjetër është, dëmtimi i pyjeve të Kosovës. Këtë çështje e kam përcjellë në vazhdimësi gjatë mandatit tim, ndërkaq nuk ka zgjidhje. Është mirë edhe ne si KK nëse ka mundësi me vepruar zona ku është dëmtuar me së shumti, si parku nacional pjesa të luboteni, kjo është jashtë kontrollit tonë dhe nuk kemi çka me bërë. Dëmtimi është duke ndodhë brenda komunës tonë. Me shikuar mundësinë që rekomandimet që dalin nga KKSB me shqyrtuar me gjetur zbatueshmëri, qoftë nga ne apo niveli qendror, ose me pranuar faktin se parku nacional është dështim dhe është duke na dëmtuar neve jashtëzakonisht shumë. Unë e di përpara se kemi qenë të kujdesshëm me ruajtur, ka pasur lisa të cilët kanë qenë të simbol si lisi i shtëpisë dhe sot janë dëmtuar, dhe sot ndej shqetësim kur i shoh se janë dëmtuar dhe prerë ata lisa. Ne duhet me ia dhënë përgjigjen kësaj çështje si KK, ose me iu adresuar ministrisë ose Kuvendit të Kosovës që ai park me na u kthyer, sa ka mbetur diçka me u ruajtur.

z. Agim Mani: Raporti i KKSB është e vetmja mundësi me u informuar qytetarët për gjendjen e sigurisë në komunë. Raporti do t'i përcjellët KK, ndërkaq ky raport është i mangët, sepse edhe rregulloret edhe udhëzimet administrative që e rregullojnë çështjen e përbërjes së KKSB, mendoj se nuk është e mirë, sepse opozita nuk është e përfaqësuar me marrë pjesë në mbledhje të KKSB. Duhet me qenë sikur në parlament, ku këshilli i sigurisë përfaqësohet nga të gjitha subjektet politike, me qenë edhe në nivel lokal një përfaqësim i tillë. Nëse ne mbetemi me u informuar përmes këtij raporti, mbetemi pa informatë, raporti është dashur me qenë me i detajuar, rekomandimet që janë dhënë për secilën pikë, me ditur realizimin e atyre rekomandimeve, mirëpo në këtë rast, me këtë raport jemi të paniformuar totalisht për gjendjen e sigurisë në komunë.

Kryesuesi i Kuvendit: Sa i përket raportit të KKSB, përbërja nuk është në kompetencën tonë, është një Udhëzim Administrativ-UA që e rregullon këtë çështje, ndoshta për shumë pozita as unë nuk pajtohem, por është një UA që e rregullon përfaqësimin në KKSB, se UA e jep me saktësi përfaqësimin dhe duhet me iu përmbajtur të njëjtit. Sa i përket raportit, ne mundemi me diskutuar a është i mirë apo i keq, a paraqet gjendjen reale etj.

znj. Ardita Rrahmani: Sa i përket përfaqësimit në KKSB, ne nuk kemi të drejtë me ndryshuar, por ne kemi të drejtë me adresuar këtë çështje në Asociacionin e Komunave të Kosovës-AKK, në mënyrë që asociacioni me adresuar çështjen në ministri, se UA mundet me ndryshuar kur nuk është në përputhje me kërkesat specifike të komunës tonë, por kjo nuk është për krejt komunat. KKSB ka aq shumë anëtarë, sa që as vet disa nuk e dinë pse janë aty. Unë bej apel që përmes Kryetarit të Komunës me adresuar si shqetësim në AKK për me pasur efekt kjo çështje, pëndryshe me u mbledhur kështu si po mblidhen nuk është kurrfarë problemi. Ky dokument, raport nuk mundet me qenë, se ka vetëm 2 faqe, ndërkaq një raport vjetor me 6 mbledhje, nuk mundet me u përmbledhur vetëm me 2 faqe, veç nëse nuk folin asgjë, ndërkaq unë besoj që temat që paraqesin, besoj se trajtohen dhe diskutohen. Lë të jetë një thirrje me hartuar një raport me të detajuar, kjo të mbetet praktikë, për ata që vijnë pas neve.

Kryesuesi i Kuvendit: Fillimisht çështja e KKSB ka qenë e rregulluar ndryshe, pastaj e bënë me një UA. Kur është hartuar UA, formalisht janë kontaktuar komunat, por nuk janë marrë parasysh kërkesat. Ju nuk e dini sesa këkesa shkojnë prej Asociacionit, është Faruku këtu prej OSBE, dhe as që merren parasysh, besoj se edhe kjo çështje iu ka adresuar, por nuk është marrë parasysh. Kështu ne të punojmë sipas UA, çështjet tjera nuk janë në kompetencën tonë. Ne si shqetësim mundemi vazhdimisht me ngritur, por sesa munden me pasur efekt nuk e dimë.

Nënkryetari i Komunës-Sabedin Vishi: Sa i përket raportit të punës së KKSB, është e vërtetë se mbajnë mbledhje çdo 2 muaj, 6 mbledhje për një vit dhe ata i shprehin shqetësimet e veta në atë këshill dhe dalin me rekomandime, në fund e bëjnë një raport. Nuk e di cilat janë kompetencat e nivelit qendror dhe atij lokal. Ka shumë rekomandime që dalin nga KKSB që janë në obligimin tonë me i zbatuar, disa janë zbatuar, ka nga to që nuk kemi mundur me i zbatuar. Çështja e pyjeve, nuk janë në kompetencën tonë, por nuk është se nuk kemi marrë masa për parkun nacional. Drejtori i bujqësisë, inspektorët dalin në terren, bëjnë inxhizime,

foto, i dërgojnë në agjencion edhe në ministri, por nuk kemi pasur ndonjë përgjigje. Tani e dini se e kanë marrë edhe pjesën e rrugës së Tetovës, ka kaluar në agjencion, pjesë kjo që ka qenë me e mbrojtur, me shumë e përkushtuar, tani edhe në këtë pjesë ka mundësi me u dëmtuar pyjet. Çështja se kush është përgjegjës me shumë apo me pak niveli qendror apo lokal, ne si komunë po i kryejmë detyrat tona. Sa i përket rekomandimeve, kemi marrë veprime për sigurinë në shkolla, kemi filluar në shkollën "Emin Duraku". E kemi pasur një plan veprimi, për dyqanet dhe trafikant që janë afër shkollave për shitje të cigareve me copa apo të ngjashme. Inspektorët na kanë raportuar, nuk kanë gjetur diçka që është përfolur. Çështja e problemit të qenëve endacak, është një problem nacional, ajo që na përket si komunës, mundohemi me trajtuar përmes DSHPE, por ndodhë që qentë endacak bartën nga një komunë në komunën tjetër. Rekomandimet që dalin nga mbledhjet e KKSBB, ne po mundohemi me i zbatuar. Një pjesë e rekomandimeve janë problem nacional që nuk mundemi me iu bërë zgjidhje.

Kryesuesi i Kuvendit: Po pajtohemi të gjithë që raporti nuk e paraqet gjithë aktivitetin e zhvilluar të KKSBB. Nga njerëzit që raportojnë në atë këshill, secili i ka kompetencat e veta, por po e shoh nga raportimet që bëhen në stacionin e policisë Kaçanik, shihet se çka raportojnë, janë 90 % të gjërave as që as nuk janë diskutua. Ajo që me shqetëson në shkolla, dukuritë negative në shkolla, që asnjë raportim nuk është paraqitur dukuria me e keqe në shkolla e që është dashur të diskutohet me së tepërmi në këtë këshill.

znj. Ardita Rrahmani: Në anën tjetër, në KKSBB është edhe përfaqësuesi i prindërve.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, është përfaqësuesi i prindërve, i shkollave, kjo çështje është dashur me u diskutuar në KKSBB, por nuk po e shoh se është diskutua.

Nënkryetari i Komunës: Në të gjitha mbledhjet e këtij këshilli, që unë kam marrë pjesë, temë e rregullt është gjendja e sigurisë në territorin e komunës së Kaçanikut.

Kryesuesi i Kuvendit: Unë e di se ka pasur trajnime të policisë në shkolla, intervenime dhe arrestime të njerëzve që janë marrë me substanca narkotike, ndërkaq as një raportim nuk është në raport. Mirë është në KK me i kërkuar këto pse nuk janë raportuar, apo pse nuk diskutohen këto tema. Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që raporti t'i shkoj KK për diskutim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së, **KPF diskutoj raportin e KKSBB. Ky raport i përcjellët KK në procedurë për diskutim.**

4. Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024;

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti është hartuar nga Zyrtarja për punë të KK, ku është munduar me paraqitur krejt aktivitetin e KK në pika të shkurtëra për gjatë një viti, se puna e KK ka qenë voluminoze gjatë vitit, ku janë prekur disa tema që janë diskutuar, vendimet që janë marrë.. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim me ia kaluar KK në procedurë diskutimi. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF diskutoj **Informatë për Aktivitetin e Kuvendit të Komunës, në vitin 2024. Informata e kalohet Kuvendit të Komunës për njoftim.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:27.. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 1 (parë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 31.01.2025, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu

Makfire Malsiu

